




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 03-02/OPK	Nr. Prot. B. prot. 01-1607/16
M. Klas. 02	Data Datum 26.04.2016
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 (paragrafi 11 dhe 12) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 26.04.2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-02-4632/15, për z. Flamur Krasniqi – Këshilltar Politik i Ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për shkak se ai ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03-02-4632/15, për z. Flamur Krasniqi – Këshilltar Politik i Ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, dhe njëkohësisht person i autorizuar në bizneset private “ESCAPE CAFFE” dhe “El Flashing”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Fillimisht, zyrtari i lartë është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, pas së cilës ai ka kontaktuar zyrtarët e AKK-së.

Zyrtari i lartë është njoftuar për situatën në të cilën ndodhet dhe për ndryshimet që duhet të bëj, për të shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik.

z. Krasniqi është zotuar se do t'i bëj ndryshimet e nevojshme për të shmangur konfliktin e interesit, duke caktuar një person të autorizuar për të menaxhuar bizneset e tij.

Ndërkohë, ai ka dërguar në AKK shkresat zyrtare nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, dëshmi me të cilat vërtetohet se zyrtari i lartë ka caktuar një person për të menaxhuar bizneset e tij private. Me këtë zyrtari i lartë ka shmangur situatën e konfliktit të interesit në të cilin ndodhej.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

